

**URDHËR**  
**Nr. 541, datë 13.11.2019**

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR  
PARAUNIVERSITAR, KOPSHTI NË FSHATIN LAVDAR, KORÇË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1, të nenit 41, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar, të kreut I/B, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 8.10.2014, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike”,

**URDHËROJ:**

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar, kopshti në fshatin Lavdar, Korçë.
  2. Transferimi i inventarit të orendive, mjeteve mësimore dhe bazës materiale të institucionit që mbyllet sipas këtij urdhri, të kryhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.
  3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Korçë, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Korçë-Pustec.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
**Besa Shahini**